

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR NJË NDRYSHIM NE LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i projektligjit është miratimi i një ndryshimi në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Me anën e këtij ndryshimi synohet zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, deri më datën 31 dhjetor 2023.

Me anën e këtij ndryshimi synohet zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të këtij ligji, deri më datën 31 dhjetor 2023.

Shtyrja e këtij afati është miratuar edhe më parë pasi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në proces hartimi i një projektligji “Për investimet”, i cili ka lindur si domosdoshmëri, pasi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë i jepte një mbrojtje shtesë investimeve të huaja, por jo atyre vendase, ndërkohë që një korpus i ri ligjor më vete ishte krijuar për investimet strategjike. Për shkak të pandemisë COVID 19, ka qenë i pamundur finalizimi i këtij projektligji të ri “Për investimet”.

Në këto kushte propozoj që afati i zbatimit të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, të shtyhet deri më datë 31 dhjetor 2023.

II. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë.

III. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë legjislacion të BE-së.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 është përcaktuar se në nenin 36 të ligjit nr.55/2015, fjalët “data 31 dhjetor 2021” zëvendësohen me fjalët “data 31 dhjetor 2023”.

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen AIDA, Komiteti i Investimeve Strategjike, si dhe të gjitha institucionet/entet dhe organet e administratës shtetërore.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE HPENZIMEVE BUXHETORE.

Miratimi i projektligjit të propozuar nuk ka efekte shtesë në Buxhetin e Shtetit.